




AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera
Office of the Prime Minister

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2013



Prishtinë
Shtator 2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2013

Prishtinë
Shtator 2014

Ky raport është përgatitur nga stafi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.
Në përgatitjen e publikimit kanë kontribuar:

Avni Kastrati, Shef i Divizionit të Statistikave të Popullsisë
Sanije Uka, Shefe e Sektorit të Statistikave të Popullsisë
Arijeta Sojeva, Zyrtare e Lartë e Statistikave Vitale
Elvira Tahiri, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë
Dren Gashi, Dizajner.

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
DSS - Departamenti i Statistikave Sociale
RAE - Rom, Ashkali dhe Egjiptian
0 - E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes
: - Mungojnë të dhënat
- - Nuk ka dukuri

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Shtator 2014
© : Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Për më shumë informata, shih: <http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Me këtë Publikim ASK-ja ka për qëllim që ta sigurojë një vlerësim të saktë statistikor të popullsisë, i cili është i nevojshëm, praktik dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune, që njëherit siguron serinë kohore të treguesve demografikë mbi ndryshimet në nivel territorial.

Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë (demografinë) janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Sidomos lidhja dhe rëndësia e veçantë e tyre me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave.

Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike.

Prandaj, për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave, këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2013.



Kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Z. Isa Krasniqi

Përmbajtja

Hyrje	9
Për shfrytëzuesit e të dhënave.....	9
Vështrimi metodologjik	9
Burimet e të dhënave	9
Popullsia bazë	10
Shtimi natyror	10
Tab. 1 Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2013 në nivel të komunave	11
Tab. 2 Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2013 në nivel të komunave	12
Tab. 3 Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2013 në nivel të komunave.....	13

H Y R J E

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Raporti përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin), që kanë ndodhur gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2013 në territorin e Kosovës.

Baza mbi vlerësimin e popullsisë

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që bëhen nga institucionet statistikore, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme. Baza e të dhënave për ta vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2013 është marrë numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2012.

Vështrimi metodologjik

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi. (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$P_n + (N-M) + (I-E)$

P_n -Numri i banorëve të përlogaritur për vitin e dhënë (2012)

N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2013

M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2013

I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2013

E –Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2013

Burimet e të dhënave

Janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore si: Vlerësimi i vitit 2012, baza e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, bazat e shënimeve nga Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve (ASK), të dhënat administrative nga disa komuna të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, baza e shënimeve nga EUROSTATI, si dhe të dhënat nga disa shtete, ku është më i shprehur emigrimi.

Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e tjera administrative nga institucionet vendore, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera.

Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për ta bërë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Popullsia bazë

Sipas “Vlerësimi të vitit 2012” numri i popullsisë rezidente në Kosovë është vlerësuar 1.815.606 banorë.

Shtimi natyror

Lindjet: sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK-së numri i lindjeve (të regjistruara) për vitin 2013 ishte gjithsej 29,327 lindje të gjalla, prej tyre me vendbanim rezident në Kosovë 29,193. Meqenëse komuniteti serb nuk i raporton të gjitha rastet e lindjeve (në regjistrim) ASK-ja ka bërë vlerësimin për numrin e lindjeve nga ky komunitet. Gjithsej, numri i regjistruar/vlerësuar i lindjeve në Kosovë për vitin 2013 ishte 29,723.

Vdekjet: sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK, numri i vdekjeve (të regjistruara) për vitin 2013 ishte gjithsej 7,625 vdekje (me vendbanimin rezident në Kosovë). Pasi që komuniteti serb nuk i raporton të gjitha rastet e vdekjeve (në regjistrim) ASK-ja ka bërë vlerësimin për numrin e rasteve të vdekjeve nga ky komunitet. Gjithsej, numri i regjistruar/vlerësuar i vdekjeve në Kosovë për vitin 2013 ishte 8,317.

Shtimi natyror: popullsia e Kosovës gjatë vitit 2013 është rritur për 21.406 banorë.

Migrimi

Imigrimi ndërkombëtar: sipas të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), UNHCR, IOM dhe të dhënat nga disa komuna, numri i të kthyerve (imigrantëve) në Kosovë gjatë vitit 2013 ishte gjithsej 3.864 banorë.

Emigrimi ndërkombëtar: numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2013 ishte gjithsej 20.246 banorë. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët legalë dhe ata ilegalë.

Migrimi kombëtar: gjatë vitit 2013 vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin (komunën) për arsye të ndryshme. Sipas vlerësimit të ASK-së, numri i personave që e kanë ndërruar komunën e mëparshme (nga një komunë në komunë tjetër) është gjithsej 9,330 banorë.

Rritje e përgjithshme

Bazuar në këto të dhëna, popullsia e Kosovës për vitin 2013 (01 janar - 31 dhjetor) vlerësohet të jetë 1,820,631 banorë rezidentë.

Tab. 1 Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2013 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2012)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			
			Nataliteti (2013)	Mortaliteti (2013)	Shtimi natyror (01.01-31.12/2013)	Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (01.01-31.12 2013)
1	Deçan	40,614	496	156	340	40,954
2	Gjakovë	96,071	1,476	420	1,056	97,127
3	Glllogoc	59,752	1,145	210	935	60,687
4	Gjilan	91,413	1,369	413	956	92,369
5	Dragash	34,410	592	227	365	34,775
6	Istog	40,150	437	199	238	40,388
7	Kaçanik	33,893	562	162	400	34,293
8	Klinë	39,467	658	182	476	39,943
9	Fushë Kosovë	36,897	727	110	617	37,514
10	Kamenicë	35,711	430	210	220	35,931
11	Mitrovicë	73,160	1,283	320	963	74,123
12	Mitrovica e V.	12,303	104	157	-53	12,250
13	Leposaviq	13,682	123	188	-65	13,617
14	Lipjan	58,909	1,125	261	864	59,773
15	Novobërdë	6,891	73	59	14	6,905
16	Obiliq	22,011	392	94	298	22,309
17	Rahovec	57,451	977	169	808	58,259
18	Pejë	98,237	831	465	366	98,603
19	Podujevë	89,185	1,677	294	1,383	90,568
20	Prishtinë	205,133	3,965	868	3,097	208,230
21	Prizren	181,756	2,880	826	2,054	183,810
22	Sknderaj	51,491	881	197	684	52,175
23	Shtime	27,940	523	94	429	28,369
24	Shtërpçë	6,966	71	65	6	6,972
25	Suharekë	61,190	1,132	346	786	61,976
26	Ferizaj	111,141	1,952	436	1,516	112,657
27	Viti	47,636	860	208	652	48,288
28	Vushtrri	71,042	1,271	336	935	71,977
29	Zubin Potok	6,592	62	82	-20	6,572
30	Zveçan	7,421	72	99	-27	7,394
31	Malishevë	56,189	1,126	179	947	57,136
32	Junik	6,212	77	27	50	6,262
33	Mamushë	5,695	56	14	42	5,737
34	Hani i Elezit	9,567	157	28	129	9,696
35	Graçanicë	11,197	83	102	-19	11,178
36	Ranillug	3,842	37	58	-21	3,821
37	Partesh	1,766	16	37	-21	1,745
38	Klllokot	2,623	25	19	6	2,629
Gjithsej		1,815,606	29,723	8,317	21,406	1,837,012

Tab. 2 Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2013 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2012)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Gjithsej popullsia dhe migrimi (01.01-31.12 2013)
			Bilanci i migrimit ndërkombëtar (2013)	Bilanci i migrimit kombëtar (2013)	Bilanci i përgjithshëm i migrimit (2013)	
1	Deçan	40,614	-366	-39	-405	40,209
2	Gjakovë	96,071	-867	-98	-965	95,106
3	Glllogoc	59,752	-539	-158	-697	59,055
4	Gjilan	91,413	-825	-55	-880	90,533
5	Dragash	34,410	-310	-101	-411	33,999
6	Istog	40,150	-362	100	-262	39,888
7	Kaçanik	33,893	-306	-112	-418	33,475
8	Klinë	39,467	-356	-32	-388	39,079
9	Fushë Kosovë	36,897	-333	662	329	37,226
10	Kamenicë	35,711	-322	-348	-670	35,041
11	Mitrovicë	73,160	-660	-100	-760	72,400
12	Mitrovica e V.	12,303	-111	0	-111	12,192
13	Leposaviq	13,682	-123	-9	-132	13,550
14	Lipjan	58,909	-532	-45	-577	58,332
15	Novobërdë	6,891	-62	80	18	6,909
16	Obiliq	22,011	-199	-5	-204	21,807
17	Rahovec	57,451	-518	-96	-614	56,837
18	Pejë	98,237	-886	-11	-897	97,340
19	Podujevë	89,185	-805	-712	-1517	87,668
20	Prishtinë	205,133	-1851	1098	-753	204,380
21	Prizren	181,756	-1640	279	-1361	180,395
22	Sknderaj	51,491	-465	-349	-814	50,677
23	Shtime	27,940	-252	-21	-273	27,667
24	Shtërpçë	6,966	-63	-36	-99	6,867
25	Suharekë	61,190	-552	-72	-624	60,566
26	Ferizaj	111,141	-1003	188	-815	110,326
27	Viti	47,636	-430	-84	-514	47,122
28	Vushtrri	71,042	-641	-124	-765	70,277
29	Zubin Potok	6,592	-59	-5	-64	6,528
30	Zveçan	7,421	-67	-8	-75	7,346
31	Malishevë	56,189	-507	-147	-654	55,535
32	Junik	6,212	-56	20	-36	6,176
33	Mamushë	5,695	-51	2	-49	5,646
34	Hani i Elezit	9,567	-86	3	-83	9,484
35	Graçanicë	11,197	-101	282	181	11,378
36	Ranillug	3,842	-35	5	-30	3,812
37	Partesh	1,766	-16	2	-14	1,752
38	Klllokot	2,623	-24	46	22	2,645
Gjithsej		1,815,606	-16,381	0	-16,381	1,799,225

Tab. 3 Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2013 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2013 (31 dhjetor 2013)
		Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2012)	Shtimi natyror (01.01-31.12.2013)	Bilanci i migrimeve (01.01-31.12.2013)	
1	Deçan	40,614	340	-405	40,549
2	Gjakovë	96,071	1,056	-965	96,162
3	Gillogoc	59,752	935	-697	59,990
4	Gjilan	91,413	956	-880	91,489
5	Dragash	34,410	365	-411	34,364
6	Istog	40,150	238	-262	40,126
7	Kaçanik	33,893	400	-418	33,875
8	Klinë	39,467	476	-388	39,555
9	Fushë Kosovë	36,897	617	329	37,843
10	Kamenicë	35,711	220	-670	35,261
11	Mitrovicë	73,160	963	-760	73,363
12	Mitrovica e V.	12,303	-53	-111	12,139
13	Leposaviq	13,682	-65	-132	13,485
14	Lipjan	58,909	864	-577	59,196
15	Novobërdë	6,891	14	18	6,923
16	Obiliq	22,011	298	-204	22,105
17	Rahovec	57,451	808	-614	57,645
18	Pejë	98,237	366	-897	97,706
19	Podujevë	89,185	1,383	-1517	89,051
20	Prishtinë	205,133	3,097	-753	207,477
21	Prizren	181,756	2,054	-1361	182,449
22	Sknderaj	51,491	684	-814	51,361
23	Shtime	27,940	429	-273	28,096
24	Shtërpçë	6,966	6	-99	6,873
25	Suharekë	61,190	786	-624	61,352
26	Ferizaj	111,141	1,516	-815	111,842
27	Viti	47,636	652	-514	47,774
28	Vushtrri	71,042	935	-765	71,212
29	Zubin Potok	6,592	-20	-64	6,508
30	Zveçan	7,421	-27	-75	7,319
31	Malishevë	56,189	947	-654	56,482
32	Junik	6,212	50	-36	6,226
33	Mamushë	5,695	42	-49	5,688
34	Hani i Elezit	9,567	129	-83	9,613
35	Graçanicë	11,197	-19	181	11,359
36	Ranillug	3,842	-21	-30	3,791
37	Partesh	1,766	-21	-14	1,731
38	Klllokot	2,623	6	22	2,651
Gjithsej		1,815,606	21,406	-16,381	1,820,631